



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2023:228586  
Datë: 23.01.2025  
Numri i dokumentit: 06748971

**Ca.nr.13423/2024**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Enes Mehmeti - kryetar i kolegjit, Nehat Idrizi dhe Faton Ademi – anëtar, në çështjen juridike të paditësit R.H., nga Prizreni, të cilin e përfaqëson B.K., dhe F.G., që të dy avokat nga Prizreni, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit – Drejtoria Komunale e Arsimit, për kompensimin e shujtave ditore -ushqimit gjatë punës, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës, kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, C.nr.3383/2023, i datës 15.07.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën **20.01.2025**, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**REFUZOHET** e pa themeltë ankesa e të paditurës Komuna e Prizrenit, Drejtoria Komunale e Arsimit në Prizren, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, C.nr.3383/2023, i datës 15.07.2024, **VËRTETOHET**.

**A r s y e t i m**

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar pa shqyrtim kryesor të çështjes ka vendosur si vijon : “...I. **MIRATOHET** në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit R.H., nga Prizreni, dhe **DETYROHET** e paditura Komuna e Prizrenit – Drejtoria Komunale e Arsimit, që në emër të kompensimit të shpenzimeve për ushqimin ditor-shujtën për 164 ditë pune (nga data 01.01.2022, deri me datën 21.11.2022), t’ia paguaj shumën e përgjithshme prej 328.00 € (164 x 2), duke e llogaritur një ditë pune me nga 2 €, me kamatë prej 8% në vit, duke filluar nga data e parashtrimit të padisë (27.10.2023), e deri në pagesën definitive, të gjitha në afatin prej 7 ditëve nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit. II. **DETYROHET** e paditura që t’ia paguajë paditësit shpenzimet procedurale dhe atë në lartësi prej 124 € në afat prej 7 ditësh pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë...”

Kundër këtij aktgjykimi, ka parashtruar ankesë e paditura përmes të autorizuarit për shkak të *shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale*, me propozim që të aprovohet ankesa e të paditurës, të priset Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren –Departamenti i Përgjithshëm Civil C.nr.3383/2023 i datës 15.07.2024 dhe të hedhet poshtë padia e paditësit, apo që aktgjykimi i atakuar të ndryshohet ose të priset dhe çështja të kthehet në rigjykim.

Përfaqësuesja e autorizuar i paditësit nuk ka parashtruar përgjigje në ankesë .

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

- Ankesa është e **pa themeltë**.

Nga shkresat e lëndës rrjedhë se paditësi R.H., nga Prizreni, të cilin e përfaqëson B.K., dhe F.G., që të dy avokatë nga Prizreni, në këtë gjykatë ka parashtruar padi kundër të paditurës Komuna e Prizrenit – Drejtoria Komunale e Arsimit, për kompensimin e shujtave-ushqimit gjatë punës, vlera e kontestit 328.00 €, ngase është kërkesë e bazuar, dhe atë për vitin 2022 duke filluar nga data 01.01.2022 deri më datë 21.11.2022, për 164 ditë pune, duke i shumëzuar me nga dy euro në ditë apo shumën e përgjithshme prej 328 euro. Paditësi shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Nga ana tjetër e paditura, përmes përgjigjes në padi, e ka kontestuar në tërësi si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditësit për të njëjtat arsye si në ankesë, duke propozuar refuzimin e të njëjtit.

Gjykata e shkallës së parë, në fazën e përgatitjes së lëndës për shqyrtim kryesor të çështjes, pas vlerësimit të deklarimeve të ndërgjyqësve dhe fakteve jokontestuese në mes tyre si dhe provave në shkresat e lëndës që kanë të bëjnë me çështjen konkrete juridike, pasi që janë plotësuar kushtet ligjore të parapara me nenin 152, lidhur me nenin 398 të LPK-së, ka marrë aktgjykimin e goditur “pa shqyrtim kryesor të çështjes”, duke vendosur që kërkesëpadinë e paditësit ta aprovoj në tërësi si të bazuar, e në shumën e gjykuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Lidhur me mënyrën e vendosjes gjykata e shkallës së parë ka vendosur se duke ju referuar dispozitës së nenit 8 par.1 dhe nenit 245, të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), e lidhur me nenin 35 paragrafi 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 22.01.2021.Vendimin mbi kamatën e ka mbështetur në nenin 382 par.1 dhe 2 të LMD-së, ndërsa vendimin për shpenzimet e ka bazuar në nenin 449, 452 dhe 453.1 të LPK-së.

Gjykata e Apelit, si gjykatë e shkallës së dytë, nisur nga kjo gjendje e çështjes, vlerëson se, përfundimi logjik dhe qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i bazuar në ligj, dhe se aktgjykimi i goditur nuk është i përfshirë me kurrfarë shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore e as atyre nga neni 182.2 pika b), g), j), k) dhe m) të LPK-së, për të cilat kjo gjykatë, si gjykatë e shkallës së dytë, kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së.

Aktgjykimi i goditur, në këtë kontest është i qartë dhe i kuptueshëm si në pjesën e arsytimit ashtu edhe në dispozitiv, ku figuron e qartë dhe e kuptueshme mënyra e vendosjes. Dispozitivi është edhe i ekzekutueshëm. E drejta materiale, për të cilën gjykata e shkallës së dytë kujdeset edhe sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, është zbatuar në mënyrë të drejtë, gjë që ka rezultuar me miratimin e drejtë të kërkesëpadsisë së paditësit në shumën e gjykuar, e që ky aktgjykim pa shqyrtim kryesor të çështjes është marrë drejtë nga gjykata e shkallës së parë pasi që janë plotësuar kushtet e parapara ligjore për marrjen e të njëjtit sipas nenit 398, të LPK-së, dhe nenit 452 të LPK-së prandaj i njëjti vërtetohet në tërësinë e tij.

Gjykata i shqyrtoi edhe pretendimet e tjera ankimore por të njëjtat ishin pa ndikim për një vendimmarrje ndryshe nga ajo që u vendos në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata e Apelit, për arsyet e paraqitura si më lart, në pajtim me nenin 195 par. 1 pika d) e LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**  
**Ca.nr.13423/2024 me datë 20.01.2025**

**Kryetari i kolegjit - gjyqtari**  
**Enes Mehmeti**